



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 03.05.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E OBELISKUT NË
PËRKUJTIM TË PJESËTARËVE TË KFOR-IT DHE TË NATO-S

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e Obeliskut në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë, në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, të cilët dhanë sakrificën e fundit derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës nga viti 1999 e deri më sot.
- II. Lokacioni për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, të cilët dhanë sakrificën e fundit derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës nga viti 1999 e deri më sot, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6233-0, ZK Prishtinë, në pronësi "Pronë shoqërore, KK Prishtinë".
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së këtij obelisku përkujtimor.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lokacioni i propozuar, i propozuar në 3D, ortofoto e lokacionit dhe obelisku i propozuar.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01- 353/01-0105419/18, më 04.05.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, të cilët dhanë sakrificën e fundit derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës nga viti 1999 e deri më sot.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka pranuar kërkesën nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për ndërtimin e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, të cilët dhanë sakrificën e fundit derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës nga viti 1999 e deri më sot.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie që ka identifikuar lokacionin për vendosjen e Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për ndërtim të lartë të përzier.

Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 6233-0, ZK Prishtinë, në pronësi "Pronë shoqërore, KK Prishtinë".

Obeliskut në përkujtim të pjesëtarëve të KFOR-it dhe NATO-s, të cilët dhanë sakrificën e fundit derisa shërbenin në mbështetje të Kosovës nga viti 1999 e deri më sot, është propozuar të vendoset në sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Prishtinë.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset Obelisku është sipërfaqe e pllakosur dhe pjesërisht e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së Obeliskut duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit. Propozohet të vendoset në mes të këtij mini-sheshi dhe sa i përket madhësisë, formës dhe materialit, është përcaktuar në kërkesën e parashtruar.

Bashkëngjitur:

Lokacionit i propozuar në 3D,
Ortofoto e lokacionit,
Obelisku i propozuar.

Lokacionit i propozuar në 3D

Obelisku i propozuar (foto ilustruese);

